



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA**  
**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA**

C.nr.191/2012

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshtjen juridike te paditësit: .  
nga Komuna e Mitrovices , te cilen e perfaqeson av. sipas autorizimit me shkrim, kunder  
te paditurve: Komuna e Mitrovices te cilen e perfaqeson Avokati Publik Komunal dhe te paditurve i  
dhe qe te dy nga . , Komuna e Mitrovices, Baza e kontestit: Vertetim pronesie, vlera e lendes se  
kontestit; 3.240,00 Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.06.04.2017 me dt. 16.06.2017 , jep kete;

**A K T G J Y K I M**

**-APROVOHET** kerkespadia e paditësit: nga , Komuna e Mitrovices dhe  
**VERTETOHET** se paditesi, eshte shfrytezues i palujtshmerise te pjeses se parc kat.596-6 ne vendin e quajtur „ -  
„ me kultur kullose e klasit te dyte me siperfaqe S = 541 m2 me masa dhe kufij qe jane shenuar ne skicen e terenit e  
evidentuar ne emer te P.SH. sipas qertifikates se pronesise 136 ZK . si dhe vertetohet se  
paditesi eshte pronar i objektit te ndertuar – lokalit me dimenzione 5.95 x 8.45 m ne siperfaqe prej S = 50 m2 si dhe shupes me  
dimenzione 4.75 m x 5.16 m me siperfaqe prej S = 25 m2 , te cilat gjenden ne palujtshmerine e sipercekur .

Detyrohen te paditurit qe t'ia njoh kete te drejte paditësit dhe te njejtit ti lejojne qe paditesi kete te drejte ta  
regjistroi prane Drejtorise per Gjeodezi dhe Kataster ne Mitrovice ne afatin prej 15 ditesh nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

**A r s y e t i m**

Paditesi ne padine e parashtruar si dhe ne seancat e mbajtura permes te autorizuarit te tij theksuar se : i  
njejti sipas kontrates gojore te lidhur ne mes shitesit e ne vitin 1991 per qmimin prej 47.500,00  
DM , e ka blere palujtshmerine tani lendore te cilin qmim e ka paguar ne teresi .

Qe nga kjo date paditesi ka hyre ne shfrytezim dhe posedim te kesaj patundeshmerie duke mos qene i  
penguar nga askush te cilen edhe sod e shfrytezton pa pengese.

Ne fjalen perfundimtare I autorizuari I paditesit I propozojn gjykates qe padine si dhe precizimin e  
kerkesepadise ta aprovoj si te bazuar nga se paditesi kete e ka fituar ne baze te kontrates gojore mbi shitblerjen si  
dhe me mbajtje me mirebesim .

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk I kerkoi.

Gjykata seancen e shqyrtimit kryesor e mbajti ne mungese te paditurit te pare , konform nenit 423.4 te  
LPK-es.

Perfaqesuesi I te paditures se pare ne pergjigje te padise si dhe kerkesepadise se paditesit ne séancet e meherhme e kundershtoi padine dhe kerkesepadine .

Te paditurit e nuk e kontestuan padine dhe kerkesepadine e paditesit duke theksuar se: eshte e vertete qe babai i tyre iu ka shitur paditesit pronen lendore ku paditesit ka paguar ne teresi qmimin e shitblerjes dhe se te njejtit nuk kane ditur se nje pjese e tokes eshte ne emer te Komunes pasi qe me vite te tera e kemi shfrytezuar ne teresi sipërfaqen dhe skemi pasur asnjehere pengesa.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk I kerkuan.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme, veproji dhe pas administrimit dhe vleresimit te te njejtave ne baze te nenit 8. Te LPK-es, erdhi ne perfundim se duhet te vendoset si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Gjykata ne procedure e provave lexoi: ekspertizen e ekspertit gjeodet Nuhi Mehmetit te dt. 11.02.2014, Plotesimin e ekspertizes te dt. 22.05.2014, procesverbalin mbi kqyrjen ne vend te kesaj gjykate te dt. 05.03.2014 , skicen e terenit te dt. 11.03.2014 , degjoi deshmitaret : dhe dhe dhe konstatoi kete gjendje faktike:

Nga ekspertiza e ekspertit gjeodet si dhe plotesimi i ekspertizes te sipercekur konstatohet se : pas matjeve te kryera te pjeses kontestuese te palujtshmerise nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Katastrit ne Mitrovice eshte vertetuar se palujtshmeria kontestuese bie – gjegjesisht e perbene parcela e cekur me larte me masa dhe kufij te shenuara si ne ekspertizen e dhene me shkrim dhe skicen e terenit te cilat jane pjese perberese te kesaj ekspertize dhe te aprovuar si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi .

Nga skica e terenit , shifet shtrirja dhe perkufizimi I palujtshmerise tani lendore.

Nga procesverbali mbi kqyrjen ne vend I kesaj gjykate I dt. 05.03.2014 konstatohet se: gjyqtari me vrojtim te drejteperdrejte konstaton se : prona kontestuese eshte pjese oborri i cili shfrytezohej per nevojat e shtepise dhe nje shtepie tjeter

Deshmitari deklaroi: une kam punuar si mjeshter tek Enveri ne vitin 2000 , e di qe token e ka blere prej dhe rreth vitit 2000 ka ndertuar edhe objekte tjera ku eshte nje dugoj .

Deshmitari Jeklaroi: une kam punuar si mjeshter tek ka fundi i vitit 2000 e din qe ate toke vend e ka blere prej dhe se perveq shtepise nuk eshte ne dijeni se ka ndertuar diqka tjeter .

Ne nje gjendje te ketill faktike te cekur me larte, gjykata erdhi ne perfundim dhe konstatoi: patundeshmerine tani lendore paditesi e ka blere nga te paditurit e dyte dhe trete qysh ne vitin 1991 , me qmim te shitblerjes prej 47.500,00 DM, ne baze te marrveshjes gojore te cilin qmim ne teresi blesesi iu ka paguar shitesve dhe qe nga momenti i shitblerjes paditesi e ka ne disponim dhe shfrytezim te lire kete patundeshmeri pa u penguar nga askush . Paditesi ne vitin 2000 ka ndertuar ne kete palujtshmeri edhe lokalin dhe shupen me dimensione sikurse qe eshte cekur ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Nga provat e cekura me larte gjykata konstatoi: se edhe pse kjo kontrat gojore mbi shitblerje eshte permushur 100% , kjo patundeshmieri juridikiisht gjere me tani nuk eshte bartur ne emer te paditesit.

Ne mes paleve ndergjygjese konstatoi se nuk ishte kontestuese fakti se : nga e paditura pare nuk eshte inicuar ndonje procedure ndaj paditesit apo te paditurve te dyte dhe trete apo paraardhesit te tyre lidhur me palujtshmerine tani kontestuese .

Ne nje gjendje te ketille faktike te vertetuar me larte, gjykata kerkesepadin e paditesit e aprovoi ne teresi si te bazuar konform nenit 21 dhe 28 te LTHMPJ-es, Gaz.Zyrt RSFJ nr.6/1980 ne fuqi prej 1 Shtatorit 1980 (neni 90) deri me 20 Gusht 2009 (nenit 296-297 te Ligjit nr.03/L-54) mbi Pronesine dhe te drejtat e tjera sendore (Gaz.Zyrt. e Republikes se Kosoves nr.57/2009 ne Kosove ne fuqi nga 22 Marsi 1989 eshte Ligj I aplikueshem bazuar ne nenin 1.1 (b) te Rregullores se UNMIK-ut nr.1999/24.

Ne baze te nenit 21 te LMTHPJ-es, eshte percaktuar se : sipas ligjit pronesia fitohet nder te tjera edhe me mbajtje.

Ne baze te nenit 28.al.4. te te njejtit ligj, parashifet kalimi I kohes prej 20 vitesh per mbajtesin e ndershem. Ne baze te provave te cekur me larte e duke marre parasysh se kete palujtshmeri paditesi e ka blere ne vitin 1991 e qe nga ky moment paditesi e ka ne shfrytezim te lir gjere me tani, gjykata konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronsise nga ana e paditesit dhe ate : ne menyre origjinere , me mbajtje duke filluar qe nga viti 1991 e gjere me tani , nga se paditesi ka qen mbajtes I ndershem I kesaj palujtshmerie tani lendore, nga se ne anen e paditesit ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronesis edhe ne baze te mbajtjes : mbajtja me mirbesim, koha e nevojshme dhe shfrytezimi I papengueshem I kesaj patundeshmerie.


Edhe ne baze te nenit 40 te Ligjit per pronesi dhe te drejtat tjera sendore (Ligji nr.03/L-154 ) eshte percaktuar se: personi I cili me mirebesim e ka 20 vjet ne posedim te panderprere nje palujtshmeri ose nje pjese te saj e fiton pronesin ne te.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore bazohet ne dispoziten e nenit 450. te LPK.

Nga si tha me larte u vendos si ne dispozitiv te ketij akgyykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË**  
**C.nr.191/2012 me dt.16.06.2017**

**Gj y q t a r i**  
**Ragip Kadriu**



**KESHILLE JURDIKE** : Kunder ketij akgyykimi mund te ushtrohet ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e pranimit , Gjykates se Apelit te Kosoves, e permese kesaj gjykate.